**INTERVISTË ME SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË OSBE-së**
**LAMBERTO ZANNIER**
*"Panorama", 5 tetor 2012*

**OSBE-ja ka ngritur përfaqësitë e veta në shumë vende të botës për të monitoruar stabilitetin dhe zhvillimin demokratik të këtyre vendeve. Sa i suksesshëm ka rezultuar ky monitorim dhe a ka rezultate konkrete të kësaj pune?**

Unë besoj se OSBE-ja ka kontribuar në mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimit demokratik të të gjitha Shteteve të saj pjesëmarrëse, përfshirë edhe vendet si Shqipëria, ku vepron një mision i saj në terren. Monitorimi është ndonjëherë i nevojshëm si parakusht për një angazhim më të gjerë dhe më operativ, që çon në rezultatet konkrete.

Për shembull, në rastin e Shqipërisë, Prezenca e OSBE-së ka ndihmuar, së fundmi, për të mbështetur miratimin e një Kodi të rishikuar Zgjedhor. Dhe mbështetja e OSBE-së për këtë proces do të vazhdojë, pasi zbatimi si duhet i Kodit është po aq i rëndësishëm sa edhe miratimi i tij.

**Mandati i OSBE-së – Pse përfshihet OSBE-ja në kaq shumë çështje? Organizata është aktive në gjithçka, që nga reforma e policisë deri te mbrojtja e të drejtave të njeriut. Si zgjedh ajo se cilat çështje duhet të adresojë në një vend të caktuar?**

OSBE-ja, që nga krijimi i saj si KSBE – Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – në vitet 1970, e ka parë gjithmonë sigurinë si gjithëpërfshirëse. Pra, është e vërtetë se OSBE-ja përfshihet në një sërë çështjesh, që variojnë nga kontrolli i armëve te mjedisi dhe te të drejtat e njeriut, pasi ajo prek të gjithat fushat që kanë rëndësi për sigurinë tonë të përbashkët.

Puna e OSBE-së përcaktohet me konsensus. Janë Shtetet pjesëmarrëse, përfshirë edhe Shqipërinë, që vendosin se cilat çështje duhen adresuar në një vend të caktuar dhe që përcaktojnë, më pas, mandatet e organeve të ndryshme të OSBE-së. Mandati i një misioni në terren vendoset me konsensus dhe i përshtatet specifikisht nevojave dhe kërkesave të vendit pritës.

**Edhe pse OSBE-ja asiston në një sërë çështjesh në Shqipëri, si në reformën elektorale, parlamentarizmin, të drejtat e njeriut, zhvillimin e medias, shoqërinë civile dhe barazinë gjinore, reformën mbi pronën, anti-trafikimin etj., përsëri Shqipëria mbetet larg vende të rajonit në këto çështje. Mendoni se kjo ka të bëjë me mungesën e traditës së një shteti të së drejtës në Shqipëri dhe kjo kërkon një strategji të re nga OSBE-ja?**

Po të shohim se nga ku e ka nisur Shqipëria, duket qartë se vendi ka bërë përparim të jashtëzakonshëm, në një kohë relativisht të shkurtër. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka lehtësuar dhe asistuar në reforma, gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit.

Megjithatë, ky progres nuk ka qenë gjithmonë pa probleme. Gjatë rrugës, ka pasur kthime prapa, rënduar nga ndarjet e thella politike në vend. Aktorët politikë shqiptarë duhet t'i kapërcejnë këto ndarje dhe të bien dakord për zgjidhje të qëndrueshme për problemet me të cilat përballet vendi. Për shembull, një progres i mëtejshëm drejt qëllimit të deklaruar të Shqipërisë për integrim evropian do të jetë i mundur vetëm nëse energjia politike kanalizohet

në përpjekje për reforma serioze dhe konstruktive nga partitë udhëheqëse. Megjithëse ky nuk është synim i drejtpërdrejtë i OSBE-së, strategjia jonë e mbështetjes së zhvillimit të institucioneve dhe proceseve demokratike mund ta lehtësojë arritjen e tij, siç është parë në rastin e Kroacisë. Por, as në Shqipëri dhe askund tjetër, OSBE-ja nuk mund të luajë rolin që u përket drejtuesve politikë vendas.

**Si e shihni bashkëpunimin midis OSBE-së dhe vendit pritës? Për sa kohë do të nevojitet një mision i OSBE-së në Shqipëri?**

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka ndërtuar një partneritet shumë të fortë me vendin pritës dhe ka dhënë një kontribut të ndjeshëm në zhvillimin e institucioneve demokratike. OSBE-ja qëndron e gatshme që të vazhdojë të sigurojë asistencë, bazuar në mandatin e Prezencës dhe në përparësitë e identifikuara nga autoritetet. Me kalimin e kohës, kjo mund të përfshijë përshtatje të mëtejshme të strukturave dhe funksioneve të saj. Prezenca do të vazhdojë të jetë aktive në Shqipëri, për sa kohë Shqipëria dhe 55 Shtetet e tjera pjesëmarrëse të OSBE-së bien dakord se ajo është e nevojshme.

**Cilat janë reformat kryesore që duhen bërë? Ku do të përqendrohet puna e OSBE-së në Shqipëri, vitin e ardhshëm?**

Është shënuar përparim i dukshëm në disa fusha, së fundmi me ndryshimet e Kodit Zgjedhor dhe heqjen e imunitetit të përgjithshëm për deputetët, gjyqtarët dhe zyrtarë të tjerë të lartë.

Bazuar mbi këtë, Prezenca e OSBE-së do të mbështesë partitë për të vijuar diskutimet kritike për një reformë gjyqësore me bazë të gjerë e gjithëpërfshirëse, e cilat është një përparësi e Presidentit Nishani. Një përparësi tjetër e rëndësishme është reforma e administratës publike dhe projektligji i mbetur pezull për Shërbimin Civil mund të shihet si një hap i rëndësishëm në këtë drejtim.

**Bazuar në këto zhvillime, si do ta konsideronit një kryesim të mundshëm të OSBE-së nga Shqipëria në vitin 2016?**

Caktimi i Kryesisë bëhet me dakordësi nga Shtetet pjesëmarrëse, pra nuk jam në gjendje të komentoj se cili vend do të marrë Kryesinë në vitin 2016.

**OSBE/ODIHR-i ka vëzhguar disa zgjedhje në Shqipëri, së fundmi në vitet 2009 dhe 2011. Në raportet e tyre renditen disa probleme dhe bëhen rekomandime për përmirësim. Si po ecën Shqipëria me zbatimin e këtyre rekomandimeve?**

Kuvendi, me meritën e tij, miratoi, më në fund, një rishikim të vërtetë të Kodit Zgjedhor dhe përmbushi shumicën e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Megjithatë, edhe kodi më i mirë zgjedhor nuk mund të bëjë shumë, nëse mungon vullneti politik për ta zbatuar në mënyrë të drejtë e në kohën e duhur. Unë do t'i nxisja të gjithë udhëheqësit dhe partitë politike që të marrin vendimet e nevojshme për të zbatuar, me mirëbesim, dispozitat e reja zgjedhore.

**Një debat i madh i zhvilluar në Shqipëri që prej zgjedhjeve të fundit parlamentare të 2009-s është votimi disa herë i zgjedhësve, duke ndikuar në rezultat. Ka mundësi OSBE-ja që të financojë një projekt të plotë të identifikimit, votimit dhe numërimit elektronik në zgjedhjet e ardhshme në Shqipëri?**

Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR-i) ka dhënë ekspertizë në këto fusha, më parë, në Shtete të tjera pjesëmarrëse të OSBE-së, megjithëse jo në Shqipëri. Financimi i projekteve të OSBE-së, shpesh, bëhet nga Shtetet individuale, në formë dhurimi. Nëse një projekt i tillë mund apo duhet të ndërmerret, kjo është një çështje që duhet diskutuar mes donatorëve të mundshëm, të cilët do të identifikonin edhe organizatën më të përshtatshme për zbatimin e këtij projekti; dhe, sigurisht, edhe pritshmëritë e vendit pritës luajnë një rol të rëndësishëm.

**Çfarë prisni të arrini këtë vit në Ministerialin e OSBE-së? Cilat janë vendimet e mëdha që kanë mbetur për t'u marrë?**

Vendimet që do të merren në Këshillin Ministerial që do të mbahet në Dublin, në datat 6 dhe 7 dhjetor, janë duke u diskutuar tani nga delegacionet e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe do të ishte e parakohshme të komentoja për to. Kryesia irlandeze po punon me Shtetet pjesëmarrëse për vendimet e mundshme në të trija dimensionet e sigurisë që mbulon OSBE-ja – ku futen dimensionet politiko-ushtarake, ekonomike, mjedisore dhe njerëzore – të cilat do të ndihmojnë në drejtimin e punës sonë gjatë viteve të ardhshme. Po diskutohen çështje të rëndësishme, mes të cilave nevoja për të trajtuar sfida të reja në fushën e sigurisë, si kërcënimet kibernetike apo çështjet e lidhura me qeverisjen e mirë ekonomike, lirinë e medias dhe tolerancën në shoqëri.

**Fund**